



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2023:112784

Datë: 22.03.2024

Numri i dokumentit: 05488405

C-IV-23-0107

Paditësi: N E të cilin e përfaqëson sipas autorizimit avokati B I nga Prishtina.

Kundër

Pala e paditur: Agjencia Kosovare e Privatizimit rruga Dritan Hoxha nr.55, Lakrishtë-Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përmes gjyqtarit Asllan Krasniqi, me datën;22.03.2024, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

1. REFUZOHET si e pa bazuar kërkesëpadija e ushtruar nga N E vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj vendimi me shkrim me numër PRZ017-0004/0163, i datës 10.03.2014, i lëshuar nga AKP.
2. Secila palë i heqë shpenzimet e veta të procedurës.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Pranë DHPGJS, është parashtruar padi nga N E kundër palës së paditur Agjencisë Kosovare të Privatizimit ndaj vendimit me shkrim me numër PRZ017-00004/0163, të lëshuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit me të cilin i ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa e parashtruesit të ankesës për kompensimin e shumës prej 1,269.00 €, në emër të kompensimit të pagave të pa paguara për periudhën nga data 01.07.1999, e deri me datën 19.12.2005, nga NSH NIN Ramiz Sadiku-Prizren (në likuidim).

Pala paditëse ndër të tjera ka theksuar se në NSH, NIN Ramiz Sadiku-Prizren është privatizuar me datën 24.03.2006, dhe se në kohën e privatizimit ka qenë punëtor i ndërmarrjes, ku me rastin e privatizimit i është ndërprerë kontrata e punës. Para Autoritetit të Likuidimit ka parashtruar kërkesë për kompensim të pagave të pa paguara, mirëpo Autoriteti i Likuidimit kërkesën e parashtruar e ka refuzuar si të pa bazuar mbi bazën e parashkrimit të kërkesës.

Në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës ligje të aplikueshme në Kosovë kanë qenë Rregulloret e UNMIK-ut 2001/27 dhe 2005/48, pastaj me vonë është aprovuar edhe Ligji i Punës. Ka theksuar se atij dhe punëtorëve tjerë në mënyrë masive iu është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe se kanë të drejtë në pagat e pa paguara nga e paditura, e cila ua ka mohuar këtë të drejtë përmes refuzimit të kërkesave me pretendimin se kërkesa është e parashkruar.

Me tutje në ankesën e parashtruar ka pretenduar se vendimi i Autoritetit të Likuidimit nuk është i arsyetuar në masë të mjaftueshme dhe se kërkesa e tij nuk është e parashkruar siç pretendohet me vendimin e Autoritetit të Likuidimit. Ligji i Punës së Bashkuar nuk është në fuqi që nga viti 1989, ngase me hyrjen në fuqi të Ligjit për Ndërmarrjet, Ligji për Punën e Bashkuar është shfuqizuar. Edhe po qëse Ligji për Punën e Bashkuar të mos jetë shfuqizuar prap se prap nuk kemi parashkrim ngase shkaktar kryesor i mos pagesës së pagave është Autoriteti i Likuidimit dhe se do të ishte e pa drejtë që për shkak të vonesave të Autoritetit të Likuidimit punëtorit t'i mohet e drejta në realizimin e pagave të pa paguara. Rregulloret e UNMIK-ut, Ligji për AKP-në dhe Ligji i Punës në Kosovë i japin të drejtë punëtorëve në pagat e pa paguara. Neni 40 të Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034, për Agjencinë Kosovare të Privatizimit parasheh prioritetet të kërkesave të lejuara në likuidim në këtë mënyrë pala e paditur ka për detyrim kompensimin e pagave të pa paguara.

Me datën 30.09.2015, me anë të parashtresës ka bërë plotësimin e padisë ku ndër të tjera i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë ta aprovoj në tërësi si të bazuar dhe me aktgjykim ta anuloj vendimin e Autoritetit të Likuidimit dhe të detyrohet pala e paditur që në emër të kompensimit të pagave të pa paguara t'ia kompensoj shumën prej 1,071.00 €, me normë të kamatës nga data 01.01.2008, e deri me datën 19.12.2012, në shkallën prej 3.5 %, ndërsa nga data 10.07.2013, e deri me datën 30.09.2015, në shkallën prej 8 %.

Kësaj padie parashtruesi si provë i ka bashkëngjitur:

- *Vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr.PRZ017-0004/0163, me të cilin është refuzuar kërkesa për kompensim të pagave në procedurë të likuidimit;*

Me datën 26.12.2023, AKP-ja përmes përfaqësuesit të sajë ka paraqitur mbrojtjen e saj ndaj ankesës së parashtruar nga N E ,ku ndër të tjera ka theksuar se NSH MIN Ramiz Sadiku (në likuidim), ka hyrë në procedurën e likuidimit me datën 29.01.2007. Me datën 01.08.2006, paditësi ka parashtruar një kërkesë, me të cilën ka kërkuar kompensimin e shumës prej 1,263.00 €, në emër të pagave të pa paguara për periudhën nga data 01.07.1999, e deri me datën 19.12.2005.

Autoriteti i Likuidimit e ka shqyrtuar kërkesën e parashtruar nga pala paditëse në atë procedurë dhe me vendimin me numër PRZ017-0004/0163, kërkesën e parashtruar nga parashtruesi i ankesës e ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar. Vendimin e vet Autoriteti i Likuidimit e ka bazuar në nenin 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit me numër 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe nenin 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar.

Me tutje në mbrojtjen e parashtruar ka theksuar se Autoriteti i Likuidimit ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe drejtë ka zbatuar edhe dispozitat ligjore. Në këtë çështje objekt i shqyrtimit është ligjshmëria e vendimit të Autoritetit të Likuidimit të nxjerrë në procedurën e likuidimit. Ankuesi me ankesë duhet të argumentoj se procedura e likuidimit nuk është bërë në përputhje me Ligjin me numër 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Parashtruesi i ankesës nuk ka treguar me ankesë se cili nen i ligjit në fjalë është shkelur dhe se në këtë mënyrë ka shkelur nenin 74.2 të Ligjit me numër 06/L-036. Po ashtu ka theksuar se në bazë të nenit 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit me numër 04/L-034, dhe nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar kërkesa e parashtruar nga parashtruesi i ankesës është e parashkruar. Kjo për faktin se parashtruesi i kërkesës pretendon në paga të pa paguara që i referohen vitit 1999, dhe nuk ka parashtruar prova se i është drejtuar gjykatës apo ndonjë organi kompetent tri vite nga arritja e borxhit të pretenduar, rrjedhimisht edhe kërkesa e tij është e parashkruar.

Përfundimisht i ka propozuar gjykatës që padinë e parashtruar nga pala paditëse ta refuzoj si të pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit në pajtim me nenin 74.2 të Ligjit Nr.06/L-086.

#### Arsyetimi Ligjor

Në bazë të nenit 76 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-086 të DHPGJS në lidhje me nenin 399 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore të Kosovës, gjykata përcakton se faktet relevante të rastit janë të pakontestueshme dhe nxjerrë këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore. Pas shqyrtimit të provave të lëndës parashtrimeve dhe pretendimeve të palëve në procedurë gjykata ka ardhur në përfundimin se padia e ushtruar në këtë çështje juridike është e pa bazuar.

Pas shqyrtimit të pretendimeve, parashtrimeve dhe provave të lëndës gjykata ka gjetur se paditësi me datën 01.08.2006, ka parashtruar një kërkesë pranë Autoritetit të Likuidimit, përmes së cilës ka kërkuar kompensimin e shumës prej 1,263.00 €, në emër të pagave të pa paguara për periudhën nga data 01.07.1999, e deri me datën 19.12.2005. Autoriteti i Likuidimit e ka shqyrtuar kërkesën e parashtruar nga pala paditëse në atë procedurë dhe me vendimin me numër PRZ017-0004/0163, kërkesën e parashtruar nga pala paditëse e ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar. Vendimin e vet Autoriteti i Likuidimit e ka bazuar në nenin 36.2 të Shtojcës së Ligjit me numër 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar.

Pala paditëse me padi ka pretenduar se ka qenë punëtor në NSH dhe nuk është kompensuar për periudhën nga data 01.07.1999, e deri me datën 19.12.2005, dhe ka pretenduar se kërkesa e tij nuk është parashkruar, ngase Ligji për Punën e Bashkuar nuk ka qenë i aplikueshëm që nga viti 1989, kur ka hyrë në fuqi Ligji për Ndërmarrjet. Në anën tjetër pala kundërshtarë e ka kontestuar ankesën duke theksuar se në rastin konkret kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës ngase parashtruesi i ankesës në lidhje me pagat e pa paguara të pretenduara nuk i është drejtuar gjykatës apo ndonjë organi tjetër kompetent tri vite nga dita e arritjes së kërkesës.

Në rastin konkret nga provat e shqyrtuara gjykata ka konstatuar se parashtruesi i ankesës pretendon në para të pa paguara që i referohen viteve 1999-2005, dhe nuk ka prezantuar prova që dëshmon se i është drejtuar gjykatës apo ndonjë organi kompetent në lidhje me borxhin e pretenduar. Kërkesën pranë Autoriteti të Likuidimit e ka parashtruar me datën 01.08.2006, mirëpo kjo kërkesë është dorëzuar si kërkesë kolektive e dorëzuar nga kërkuesi A R si përfaqësues i grupit të punëtorëve pa pasur autorizim të vlefshëm. Autoriteti i Likuidimit ka bërë kërkesë për dorëzimin e autorizimit, me datën 18.03.2013, mirëpo përkundër kërkesës së bërë autorizimi nuk i është dorëzuar Autoritetit të Likuidimit.

Me nenin 376 paragrafi 1 të LMD-së (1978) e cila dispozitë në mënyrë shprehimore përcakton se “kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që e ka bërë dëmin”. Në rastin konkret në kuptim të dispozitës së lartë cekur gjykata ka ardhur në përfundimin se kërkesa e pretenduar e palës paditëse për kompensim të pagave që i referohen periudhës nga data 01.07.1999, e deri me datën 19.12.2005, është e parashkruar.

Shpenzimet e procedurës;

Në bazë të nenit 62 paragrafi 5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës secila palë do ti heqë shpenzimet e veta.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, brenda 15 ditësh, llogaritur nga data e pranimit të këtij aktgjykimi.

Gjyqtari;  
Asllan Krasniqi